

Legjislacioni Bujqësor

Hyrje në Legjislacion:

- Me termin legjislacion ose ligjshmëri, nënkuptojme tërsin e akteve ligjore dhe nënligjore të një shteti, që kanë të bëjnë me një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore si psh. legjislacioni penal, legjislacioni civil, legjislacioni bujqësor, legjislacioni i sigurimeve shoqërore etj.
- Një çështje, një veprim apo vendim është i ligjshëm, kur ajo/ai është në përputhje me ligjin, që bëhet sipas ligjit, që bazohet tek ligji
- Në kuptimin figurativ do të thote që është me vend, i drejtë, i arsyeshëm, plotësishte i kuptueshëm, i natyrshëm, kërkesë e ligjshme, e drejtë e ligjshme
- Ligjshmëria presupozon një veprim ose akt i cili është në përputhje me ligjin, të qenit i ligjshëm, ligjshmëri e vendimeve ose veprimeve etj
- Ligjshmëria është zbatimi i përpikt i ligjeve në fuqi në një shoqëri apo shtet të caktuar

Ç'është ligji

- a.) Në aspektin juridik, është një norm ose rregull që vendoset nga organi me i larte i pushtetit shtetëror dhe që është i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjitha organet shtetërore si dhe nga të gjithë shtetasit
- b.) Në aspektin etik është një rregull ose norm që e pranojme dhe e zbatojme të gjithë si dicka e përgjithshme ose të detyrueshme si psh. ligje te mirësjelljes etj
- c.) Në kuptimin filozofiko-shkencor, është lidhja e brendshme, e qensishme dhe e domosdoshme ndërmjet sendeve e dukurive të natyrës e të shoqërise, që percakton zhvillimin e tyre dhe e ben procesin botëror nje te tere te vetme. Ketu perfshihen ligjet e zhvillimit te natyres, te shkences dhe te shoqerise
- d.) Në kuptimin specifik, jane pergjithesime qe nxirren nga vezhgimet dhe studimet e dukurive te natyres e te shoqerise, duke zbuluar ne ate qe eshte e perbashket, e rregullsishme dhe qensore
- e.) Në kuptimin fetar, eshte nje sistem rregullash qe feja kerkon te zbatohen rreptesishte nga besimtaret

Hyrje në Legjislacion:

Terminologji juridike:

- “Juridik” – kuptojme dicka që lidhet me normat dhe me ligjet e së drejtës
- “Person juridik” – është një person, subjekt, ndermarrje, institucion, etj që i është njohur ligjrisht e drejta të përfaqesoj vetëveten para shtetit për veprimtarin që kryen
- “Juridiksion” – është e drejta e një organi për të bërë një gjyq, për të zgjidhur një çështje, për të ushtruar një veprimtari të caktuar në përputhje me ligjin
- “E drejta” – është tersia e normave që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore ndërmjet njerzve, në një vend të caktuar, të cilat vendosen nga shteti e mbrohen me ligj
- “Drejtësi” – të qenit i/e drejtë, cilësia e atij/e asaj që është e drejtë, vertetësia

Legjislacioni Bujqësor në Kosovë

Historiku:

- Në Kosovë kemi një legjislacion bujqësor të vendosur pas vitit 1999
- Më herët ishte pjesë e legjislacionit të ish Jugosllavisë
- Kemi daljen për herë të parë të **ketyre ligjeve:**

Viti 2003:

1. **Ligji Nr. 2003/3: PËR PYJET E KOSOVES**
2. **Ligji Nr. 2003/5: I KOSOVES PËR FARËRAT**
3. **Ligji Nr. 2003/9: PËR KOPERATIVAT E BUJQËVE**
4. **Ligji Nr. 2003/20 PËR PESTICIDET**

Ligjet bujqësore të aprovuara deri tani:

Viti 2004:

5. Ligji Nr.2004 / 21: PËR VETERINARINË

6. Ligji Nr. 2004/29 : PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT NR.2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS

Viti 2005:

8. Ligji Nr. 02/L-9: PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

9. Ligji Nr. 02/L-26: PËR TOKËN BUJQËSORE

Viti 2006:

10. Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Viti 2007:

11. Ligji Nr. 02/L-111: PËR BLETARI

12. Ligji Nr. 02/L-122: PËR BUJQËSINË ORGANIKE

Ligjet bujqesore te aprovuara deri tani:

Viti 2008:

- 13. Ligji Nr. 03/L-029: PËR INSPEKSIONIN BUJQËSOR**
- 14. Ligji Nr. 03/L-042: I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

Viti 2009:

- 15. Ligji Nr. 03/L-016: PËR USHQIMIN**
- 16. Ligji Nr. 03/L-098: PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Viti 2010:

- 17. Ligji Nr. 03/L-097: PËR MASAT ANTIDAMPING DHE MASAT KUNDËRBALANCUESE**

Viti 2011:

- 18. Ligji Nr. 04/L-047: PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORTE**

Ligjet bujqesore te aprovuara deri tani:

Viti 2012:

- 19. Ligji nr. 04/L-074: PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
- 20. Ligji Nr. 04/L-040: PËR RREGULLIMIN E TOKËS
- 21. Ligji Nr. 04/L-085: PËR BUJQËSI ORGANIKE (Amandamentim, shfuqizohet ai i vitit 2007)
- 22. Ligji Nr. 04/L-090: PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
NR. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL
- 23. Ligji Nr. 04/L-121: PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Viti 2013:

- 24. Ligji Nr. 04/L-191: PËR BLEGTORINË

Aprovimi i Ligjeve nga 1999-2008

Shembulli 1

UNITED NATIONS
United Nations
Administration Mission
in Kosovo

Interim



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004 / 21

PËR VETERINARINË

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/ 9 të dt. 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreu 9.1.26 (a) dhe 5.1. (j),

Me qëllim të vendosjes dhe përforcimit të kërkesave në fushën e veterinarisë, shëndetit publik veterinar, prodhimet mjekësore veterinare, ushqimeve të kafshëve, mirëqenie të kafshëve dhe rregullimit të profesionit të veterinarisë,

Aprovon:

LIGJIN PËR VETERINARINË

Aprovimi i Ligjeve pas Shpalljes së Pavarësisë (17 Shkurt 2008)

Shembulli 2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-016

PËR USHQIMIN

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të krijimit të bazës ligjore për rregullimin e kërkesave në fushën e ushqimit, mbrojtjes së shëndetit publik dhe përcaktimit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit,

Miraton

LIGJ PËR USHQIMIN

Ligji Nr. 2003/3: PËR PYJET E KOSOVËS

- Dispozitat e pergjithshme (Neni 1)
- Definicionet e pergjithshme (Neni 2)
- Qellimet dhe standardet e menaxhimit te pyjeve (Neni 3)
- Gjendja e tokes, pronesia dhe perdorimi (Neni 4)
- Pronesia mbi token dhe transferi (Neni 5)
- Struktura e organeve qeveritare pyjore (Neni 7)
- Agjencia Pyjore e Kosoves (Neni 7)
- Fondi per ripertrirjen e pyjeve (Neni 8)
- Bordi Pyjor Keshilldhenes (Neni 9)
- Pyjet private dhe menaxhimi i tyre (Neni 11 - 15)
- Pyjet publike dhe menaxhimi i tyre (Neni 16 – 21)
- Kafshet ne pyll (Neni 22)
- Transporti i trungjeve – lejet e import-eksportit (Neni 25)
- Mbrojtja dhe ripertrirja e pyjeve (Neni 26 – 28)
- Zbatimi (Sherbimi i mbrojtjes, inspeksioni pyjor) (Neni 29-30)
- Ndeshkimet (Nga 2.000 – 25.000 Euro) (Neni 36)

Ligji Nr. 2003/5: I KOSOVËS PËR FARËRAT

- Dispozitat e pergjithshme (Neni 1-3)
- Lista e farerave te Kosoves dhe te drejtat e kultivuesve te bimeve (Neni 5)
Zyra e te drejtave te varieteteve te bimeve (f-onet dhe detyrat)
- Plotesimi i kerkeses per listen e farerave te Kosoves (Neni 6)
- Kriteret qe kane te bejne me listen e farerave te Kosoves (Neni 7)
- Testimi i varieteteve te bimeve per tu perfshire ne listen e farerave te Kosoves (Neni 8)
Testimi per dallueshmeri, uniformitet dhe stabilitet (DUS)
Komisioni i listes se farerave te Kosoves (5 anetar) – I emeruar nga Ministri I MBPZHR
- Heqja e nje varieteti nga lista e farerave te Kosoves (Neni 9)
- Procedura e ankesave (Neni 11)
- Kontrolllo i prodhimit, certifikimit dhe tregtimit te fares (Neni 12)
- Inspektimi i prodhimit te fares (Neni 13)
- Etiketimi i prodhimit te fares (Neni 14)
- Marrja e mostres per nje sasi te fares (Neni 16)
- Testimi i fares (Neni 17)
- Kontrollimi i fares se importuar dhe patateve per fare (Neni 20-22)
- Eksporti I farerave dhe patateve per fare nga Kosova (Neni 23)
- Ndeshkimet (15.000 – 50.000 Euro) (Neni 24)

Ligji Nr. 2003/20: PËR PESTICIDET

- Definicionet (Neni 1)
- Regjistrimi i pesticideve (Neni 2)
- Kerkesa per licence (Neni 3)
- Taksat per licence (Neni 4)
- Licenca per importin e pesticideve (Neni 5)
- Licenca per eksport te pesticideve (Neni 6)
- Licenca per prodhim te pesticideve (Neni 7)
- Barnatoret bujqesore (Neni 10)
- Leshimi ne qarkullim dhe reklamimi i pesticideve (Neni 11, 12)
- Pesticidet e ndaluara dhe ato rreptesishte te ndaluara (Neni 13)
- Inspektimi (Neni 17)
- Shkeljet dhe ndeshkimet (5.000 – 50.000) (Neni 18)

Ligji Nr.2004 / 21: PËR VETERINARINË (49 nene)

- Dispozita të përgjithshme (Neni 1)
- Zbatimi (Neni 2)
- Definicionet (Neni 3)
- Kërkesat veterinare (Neni 4)
- SHVUK – Organizimi (Neni 5, 6, 7)
- Kontrolli i sëmundjeve infektive dhe ngjitëse (Neni 8)
- Masat financiare (Neni 9, 10)
- Lajmerimi i sëmundjeve infektive (Neni 11):
- Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve bujqesore (Neni 12)
- Identifikimi dhe regjistrimi i qenve dhe maceve (Neni 13)
- Lëvizja e kafshëve të gjalla, produkteve shtazore dhe produkteve embrionale (Neni 14)
- Kushtet e importit të kafshëve të gjalla , produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale (Neni 15)
- Prodhimi, përpunimi dhe plasimi në treg i kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore (Neni 16)
- Kushtet e eksportit të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale (Neni 17)
- Ndalimi i përdorimit të substacave të caktuara dhe përdorimi i mbetjeve dhe patogjenëve (Neni 18)
- Dispozitat ndëshkimore (Neni 45)

LIGJI PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi i Ligjit

- Ky Ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin dhe funksionimin e subjekteve që ofrojnë shërbime dhe shfrytëzuesve të shërbimeve dhe organizimin e mirëfilltë të tyre në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore
- Ky Ligj rregullon organizimin dhe administrimin e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë, kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësisë të subjekteve të ujitjes dhe kullimit, formimin dhe regjistrimin e kompanive të ujitjes, shoqatave të përdoruesve të ujit për ujitje, Federatave, organizimin e tyre, tarifrat e ujit për ujitje, afarizmin e shoqatave dhe çështje të tjera lidhur me ujitjen dhe kullimin

II. ADMINISTRIMI I UJITJES

- Ministria (MBPZHR) është përgjegjëse për krijimin dhe implementimin e politikave të ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë
- Kompanitë e bëjnë menaxhimin e ujitjes në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj
- Shoqatat dhe Federatat e bëjnë shfrytëzimin e ujit për ujitje dhe menaxhimin e pjesëve të Sistemeve të Ujitjes të cilat iu janë dhënë në shfrytëzim në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme

Kompetencat e Ministrisë

- Ministria, në lëmin e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore ka këto kompetenca:
 - a) përcakton politikat e ujitjes dhe kullimit
 - b) vendos kriteret dhe i propozon limitet për tarifatat për ujitje
 - c) si anëtare e bordit mbikëqyrës vlerëson planet afariste që të sigurohet në zbatimin e politikave të aprovuara,
 - d) jep pëlqimin për bartjen e përgjegjëseve të menaxhimit të kanaleve sekondare dhe terciare dhe objekteve përkatëse nga kompania në shoqatë, brenda kufijve përkatës
 - e) përcakton përgjegjësitë dhe kufinjët në mes të kompanive dhe shoqatave si dhe në mes të shoqatave
- Ministria, përmes Seksionit për Ujitje dhe kullim është kompetente për mbikëqyrjen dhe kontrollin e bartjes së përgjegjëseve menaxhuese të kanaleve sekondare dhe terciare të ujitjes nga kompania në shoqatë – federatë dhe
 - a) të mbajë regjistrin e kompanive, shoqatave dhe federatave,
 - b) t'i këshillojë dhe udhëzojë kompanitë, shoqatat dhe federatat për çështje në lëmine ligjore dhe financiare,
 - c) të bëj monitorimin e ujitjes, kullimit dhe cilësisë së ujit për ujitje në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
 - d) emëron anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të kompanive, sipas kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria dhe monitoron zgjedhjen e organeve të shoqatave
- Ministri vendosë që transferi i të drejtës së shfrytëzimit të objekteve dhe përgjegjëseve të kryhet në bazë të transferit në përdorim sipas ligjeve të aplikueshme
- Për objektet e ujitjes të cilat iu shërbejnë dy apo më tepër shoqatave, Ministria mund të vendosë që e drejta e shfrytëzimit të bartet në federatë

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMPANISË

- Uji për ujitje ofrohet përmes infrastrukturave kryesore që operohen nga Kompanitë e regjistruara dhe licencuara si ofruese të shërbimeve
- Kompanitë operojnë sipas kushteve të licencës së tyre, në pajtim me autorizimet e dhëna nga Ministria sipas Udhëzimeve administrative. Licenca do të specifikoj kushtet e aplikueshme për dhënien e të drejtës, territorit, kohëzgjatjes, vazhdimit të kohëzgjatjes së licencës
- Kompanitë Publike brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre kanë për obligim që:
 - të ndërtojnë, operojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në mënyrë biznesi dhe në pajtim me interes të përgjithshëm,
 - të ofrojnë ujë për ujitje me kohë, në sasi të mjaftueshme dhe në kualitet të kërkuar për nevojat e përdoruesve dhe bëjnë kërkesa përmes MBPZHR-, Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për sasitë e ujit që nevojiten,
 - të ofrojnë kontratat përkatëse përdoruesve të ujit për shërbimet e tilla dhe të mbledhin taksat për shërbimet e ofruara,
 - të udhëzojnë dhe vlerësojnë kërkesat e reja për intervenime në infrastrukturën e ujit për ujitje nga personat, dhe të ofrojnë shërbimet korresponduese,
 - të jenë në pajtueshmëri me statutet dhe aktet nënligjore të aprovuara nga autoritetet rregullative,
 - të mbajnë ndaras, të kontrolluar financiarisht në mënyrë të pavarur llogaritë vjetore dhe planet vjetore të biznesit në disponueshmëri të Bordit Mbikëqyrës.
 - Të caktojnë çmimin e ujit për ujitje nga përdoruesit në koherencë me kapacitetet e tyre financiare,

Kompanitë e Ujitjes, janë përgjegjëse për:

- menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën juridiksionin e saj,
 - sigurimin e ujit për ujitje në kohë dhe në sasi të mjaftueshme për shfrytëzuesit e shërbimeve sipas planit vjetor të harmonizuar me shfrytëzuesit,
 - lidhjen e kontratave me shfrytëzuesit e ujit për ujitje për shërbimet e ofruara dhe inkason nga ata kompensimin material për shërbime,
 - në rast të shkakimit të dëmeve subjekteve të tjerë, të pësuar si pasojë e defekteve në infrastrukturën e ujitjes, bënë vlerësimin dhe kompensimin e tyre
 - dhënien e pëlqimit për çdo ndërhyrje të re nga personat fizik në infrastrukturën e ujitjes,
 - hartimin e planeve zhvillimore për investime të reja për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitjes, me të cilat plane do ta njoftojë Ministrinë, në harmoni me planet tjera zhvillimore
- Kompanitë janë ndërmarrje publike që mbikëqyren nga Bordi Mbikëqyrës

SHOQATAT E PËRDORUESVE TË UJIT PËR UJITJE

- Shoqata është entitet jo profitabil i krijuar në bazë vullnetare në përputhje me dispozitat e këtij Ligji
- Për tu krijuar një shoqatë nevojitet pëlqimi i 51% i fermerëve që gravitojnë në territorin e shoqatës që do të krijohen.
- Çdo person fizik a juridik që ka në pronësi ose në shfrytëzim tokë brenda zonës nën ujitje të një shoqate, ka të drejtë të bëhet anëtar i saj.
- Shoqata harton dhe dërgon statutin e vet në Ministri dhe regjistrohet në organin kompetent

Detyrat kryesore të Shoqatave janë:

- a) Operimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për ujitëse
- b) Furnizimi i vazhdueshëm me ujë për ujitje i të gjithë anëtarëve dhe jo-anëtarëve në kushte jo diskriminuese dhe të paanshme
- c) Grumbullimi i pagesave që i takojnë shoqatës / federatës.
- d) Harto planin e ujitjes sipas kulturave dhe bënë bilancin e nevojave të ujit për ujitje

FEDERATAT E PËRDORUESVE TE UJIT

- Federata, krijohet në mënyrë vullnetare me bashkimin e dy apo më tepër shoqatave me qëllim të administrimit dhe shfrytëzimit të ujit për ujitje.
- Çdo shoqatë e cila furnizohet me ujë nga një kanal, gypsjellës, rezervuar apo presë e ujit që shfrytëzohet nga një federatë, gëzon të drejtën e anëtarësimit në atë federatë.
- Ministria përcakton rregullat dhe procedurën që duhet zbatuar për krijimin e federatës, sipas këtij ligji
- Detyrat kryesore të federatës janë:
 - a) shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e objekteve kryesore, kanaleve, rezervuarëve dhe e infrastrukturës përkatëse të ujitjes,
 - b) furnizimi me ujë për ujitje i shoqatave anëtare dhe jo anëtare të federatës,
 - c) ndërmarrja e aktiviteteve në menaxhimin dhe veprimet e nevojshme ndërtimore për funksionimin normal të sistemeve të ujitjes,
 - d) grumbullimi i pagesave nga shërbimet për mirëmbajtjen investive të objekteve me të cilat disponon federata

REGJISTRI I SHOQATAVE DHE FEDERATAVE

- Ministria e mbanë regjistrin e kompanive, shoqatave dhe federatave i cili duhet të përmbajë:
 - a) emrin dhe selinë e kompanive, shoqatave dhe federatave,
 - b) zonat nën ujitje të cilat i mbulojnë dhe madhësitë e tyre,
 - c) numrin e anëtarëve dhe jo anëtarëve,
 - d) inventarin dhe infrastrukturën e tyre,
 - e) të dhënat mbi afarizmin e tyre i cili mbikëqyret nga Ministria
- Të dhënat të cilat duhet t'i mbajnë kompanitë, shoqatat dhe federatat përcaktohen me statutin e tyre
- Ministria është e autorizuar që të bëjë monitorimin e infrastrukturës së ujitjes dhe, nëse konstaton se ndonjë objekt i ujitjes ka mangësi teknike, kërkon mënjanimin e tyre
- Kompanitë, shoqatat dhe federatat janë të obliguara që ta njoftojnë Ministrinë lidhur me gjendjen teknike të sistemeve të ujitjes, para çdo sezone të ujitjes

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

- Me dënim me gjobë prej 500 € deri në 5.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi, shoqata dhe federata në rast se:
 - a) dëmton sistemin e ujitjes apo infrastrukturën e tij,
 - b) dëmton pjesën tjetër të tokës si pasojë e shfrytëzimit të pakujdesshëm të ujit,
 - c) ndërton çfarëdo objekti mbi sistemet e ujitjes.
 - d) në mënyrë ilegale dhe të paautorizuar kyçet dhe e shfrytëzon sistemin e ujitjes.
 - e) nuk i mbanë të dhënat sipas nenit 34, alineja 2
 - f) nuk iu përmbahet rregullave sipas nenit 35

Ligji Nr. 02/L-26: PËR TOKËN BUJQËSORE

- Me këtë ligj përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm
- Qëllimi: Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më këtë ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij
- Shfrytëzimi i tokës bujqësore: Pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore është i detyruar që tokën bujqësore t'a shfrytëzoj në mënyrën e cila i përshtatet vetive natyrore të tokës, duke mos e zvogëluar vlerën e saj dhe duke përdorur masat agroteknike përkatëse
- Nëse pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore nuk e shfrytëzon tokën sipas paragrafit 1 të këtij neni do të bëjë përpjekje të siguroj shfrytëzimin e saj përmes dhënies së tokës më qira apo në mënyrë tjetër në pajtim më dispozitat e dhënies së paluajtshmërive në shfrytëzim

Kullotat nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera përveç rasteve të përcaktuara me ligj

- Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kullotat mund të shndërrohen në kulturë ose shfrytëzim tjetër, nëse me këtë arrihet shfrytëzimi më racional dhe ekonomik i tokës, por duke mos shkaktuar erozion dhe pengesa në shfrytëzimin normal të kullotave tjera.
- Ndërrimi i destinimit të kullotave bëhet sipas dispozitave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore
- Lartësinë e taksës për shfrytëzim të kullotave në pronësi publike e cakton Ministria me akt nënligjor të veçantë. Tatimi për shfrytëzimin e kullotave publike duhet të ndërlidhet me kapacitetin e tokës dhe të llogaritet në bazë të numrit të bagëtive që mund të kullosen në atë tokë.
- Kompensimi për shfrytëzimin e kullotave paguhet në llogari të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe mund të përdoret për përmirësimin e kullotave.
- Në kullotat që gjenden mbi kufirin natyror dhe më të lartë të vegetacionit pyjor ose që janë krijuar me uljen e këtij kufiri pyjor, Ministria do të përcaktoj afatet e fillimit dhe përfundimit të kullotjes dhe ndalohej kullotja e bagëtive para dhe pas këtyre afateve.

Shfrytëzimi i kullotave

Shfrytëzuesi i kullotave ka për detyrë:

- a) të bëjë shfrytëzimin racional të kullotave;
- b) t'u mundësoj shfrytëzuesve tjerë kalimin, afrimin dhe dërgimin e bagëtisë në kullota dhe në fusha, si dhe caktimin e vendit për dhënien ujë bagëtisë;
- c) të bëjë vazhdimisht meliorimin dhe mirëmbajtjen me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe shtimit të kapaciteteve të kullotave dhe
- d) të zbatojë masat e mbrojtjes së kullotave nga shfrytëzimi i tepërt dhe jodestinues.

Ndalimi i kullotjes së bagëtisë nomade

- Me qëllim të mbrojtjes së kulturave bujqësore dhe për të parandaluar paraqitjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse të bagëtisë, dhe për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga zoonozat të cilat mund të barten nga bagëtitë të njerëzve, ndalohet kullotja e bagëtisë nomade në toka bujqësore pa certifikatën veterinere
- Nuk konsiderohet kullotje nomade, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kullotja e zakonshme e bagëtisë në kullota në pronësi të mbajtësit të bagëtisë, në kullota të marra me qira apo në kullota publike.
- Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet e ndalimit të kullotjes së bagëtisë nomade

Mbajtja e evidencës për tokat bujqësore

- Personat juridik që merren më veprimtari bujqësore janë të obliguar të mbajnë evidencën për tokën bujqësore të cilën e shfrytëzojnë apo e posedojnë.
- Organi komunal kompetent për bujqësi është i obliguar të mbajë evidencë për tokën e pa punuar, tokën e dhënë në shfrytëzim, dhe evidencën për tokën të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit.
- Organi kompetent komunal këto të dhëna ia dërgon Ministrisë sipas kërkesës së saj

Servituti sezonal

- Nëse pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore nuk mund të hyj në tokën e tij pa kaluar nëpër tokën e personit tjetër, ai ka të drejtë të kërkoj që ti lejohet kalimi nëpër tokën fqinje për të kryer punët sezonale.
- Servituti sezonal bëhet me procedurë të shkurtë dhe shërben derisa punët e fushës (lëvrimi, mbjellja, korrja, bartja e prodhimeve dhe punët tjera) të mos kryhen
- Servitutin sezonal, vlerësimin e dëmit dhe lartësinë e kompensimit e cakton organi kompetent komunal, ndërsa kompensimin e dëmit e bënë shfrytëzuesi i servitutit sezonal.
- Ankesa kundër vendimit të organit kompetent komunal i bëhet Ministrisë dhe nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit.

MBROJTJA E TOKËS BUJQËSORE

Klasifikimi i tokës bujqësore

- Më qëllim të mbrojtjes së potencialit bujqësor dhe shfrytëzimit racional të tokës bujqësore Ministria do të caktoj kriteret e klasifikimit të tokave bujqësore sipas bonitetit dhe do të mbajë hartat e klasifikimit.
- Çdo ndërrim i destinimi sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të bëhet vetëm sipas ligjit dhe me vendim të organit kompetent komunal, pasi të jetë marrur pëlqimi nga Ministria në projektin e rregullimit hapësinor
- Përjashtimisht kur nuk ekziston ndonjë mundësi tjetër dhe kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm toka bujqësore, përkatësisht toka pyjore e klasit 1 - 4 me plan hapësinor, përkatësisht me plan zhvillimor komunal, mund të përcaktohet si tokë për destinime tjera.
- Toka bujqësore në bazë të bonitetit të saj klasifikohet në 8 klasë.
- Në planet hapësinore sipas vlerës së shfrytëzimit dhe bonitetit të saj toka bujqësore përcaktohet:
 - a) klasa e 1-4 përcaktohet vetëm si tokë bujqësore, përkatësisht si tokë pyjore;
 - b) klasa e 5 dhe 6 përcaktohet si tokë bujqësore, pyjore dhe përjashtimisht si tokë për qëllime të tjera;
 - c) klasa 7 dhe 8 përcaktohet si tokë bujqësore e cila sipas nevojës shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera
- Vlerësimin e klasifikimit të tokës sipas bonitetit do ta bëjë institucioni i autorizuar nga Ministria. Vlerësimi pastaj i përcillet Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për shqyrtim dhe inkorporim në planet hapësinore

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore

- Tokat bujqësore shfrytëzohen vetëm për prodhimtari bujqësore dhe përjashtimisht mund të shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera vetëm në rastet e përcaktuara me këtë Ligj.
- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj.
- Hartuesi i planit hapësinor dhe planit zhvillimor komunal, duhet të ketë kujdes për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve tjera e sidomos mbrojtjen e tokës bujqësore në sistemin e ujitjes.
- Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të fillojë të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër.
- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore nga klasa 7-8, nëse nuk është i bazuar në planin e rregullimit hapësinor, do të bëhet me pëlqim urbanistik.
- Pëlqimin urbanistik e jep organi kompetent për planifikim hapësinor në pajtim me pëlqimin e organit kompetent komunal për bujqësi.
- Përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, toka bujqësore, përkatësisht pyjore, prej klasit 1-6 mund të shfrytëzohet për qëllime tjera, për ndërrim të përkohshëm të destinimit, vetëm në rastet e përcaktuara me nenin 13.1 (b) të këtij Ligji, përveç ndërrimit të përkohshëm të shfrytëzimit të lëndëve industriale dhe minerale në mihjet sipërfaqësore më të mëdha se 0,5 ha. Ndërrimi i përkohshëm i destinimit përcaktohet me pëlqim urbanistik të organit kompetent për planifikim hapësinor në pajtim me pëlqimin e organit kompetent për bujqësi. Pëlqimi i organit komunal për bujqësi epet në formë të vendimit.
- Me pëlqimin urbanistik përcaktohet afati deri kur toka duhet të kthehet në tokë për prodhimtari bujqësore.
- Afati për ndërrim të destinimi nga paragrafi 7 i këtij neni nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vite
- Toka bujqësore e cila me planin hapësinor është përcaktuar si tokë për qëllime jo bujqësore, mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore deri në momentin e fillimit të ndërtimit të objektit, përkatësisht kryerjes së punëve tjera
- Organi komunal kompetent për bujqësi është i detyruar të sigurojë se toka bujqësore do të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore sipas paragrafit 1 të këtij neni

Ndërrimi i përhershëm dhe i përkohshëm i destinimit

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të jetë i përhershëm dhe i përkohshëm

a) ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohet çdo ndërrim i destinimit i cili bëhet për ndërtimin e vendbanimeve, objekteve industriale, hekurudhave, komunikacionit rrugor, rezervuarëve të ujit, aeroporteve, linjave të ndryshme instaluese apo objekteve të tjera të cilat përgjithmonë pamundësojnë shfrytëzimin e tokës bujqësore për prodhimtari bujqësore.

b) ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore, depozitë e mbeturinave, hirit industrial dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Toka bujqësore pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

- Shfrytëzimi i rërës, zhavorrit dhe gurëve konsiderohet ndërrim i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore në rastet kur këto gjenden në tokën e përcaktuar si tokë bujqësore.
- Në rastet e ndërrimit të destinimit nga paragrafi 1 (b) dhe paragrafi 2 i këtij neni, shfrytëzuesi është i detyruar që pas përfundimit të shfrytëzimit apo përfundimit të afatit të përcaktuar për ndërrim të përkohshëm të destinimit, tokën t'a kthej në gjendjen e mëparshme

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Qëllimi:

- Me këtë ligj rregullohet menaxhimi me resurse peshkore dhe veprimtaria e peshkatarisë dhe akuakulturës që ushtrohet në ujërat e territorit të Kosovës

Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim që:

- a) peshqit në ujërat e peshkimit të shfrytëzohen në mënyrë racionale për tu ruajtur biodiversiteti;
- b) peshqit mund të peshkohen dhe kultivohen vetëm sipas kushteve të parapara me këtë ligj dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj;
- c) të përcaktoi kushtet e menaxhimit dhe mbikëqyrjen e resurseve peshkore;
- d) të përcaktoi masat për mbrojtjen e peshqve,
- e) të përcaktojë të drejtat dhe obligimet e personave fizikë apo juridikë që ushtrojnë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

UJËRAT E PESHKIMIT – Kush dhe si mund te shfrytezohen?

- Ujëra të peshkimit janë të gjitha ujërat në territorin e Kosovës përveç ujërave:

- a) të shpallura si territore të mbrojtura me ligj të veçantë,
- b) në hurdhra të peshqve,
- c) në akumulime, liqene apo burime nga të cilat sipas ligjeve apo vendimeve të veçanta mbrohet burimi për furnizim me ujë të pijes,
- d) Në akumulime, liqene apo burime ujore të rezervuara për furnizim me ujë të pijes

- Ujërat e peshkimit ndahen në regjione apo zona të peshkimit
- Kufijtë e regjioneve apo zonave të peshkimit, forma e shfrytëzimit për peshkim ekonomik apo sportiv dhe zonat për akuakulturë përcaktohen me akte nënligjore nga ministria duke marr mendimin profesional nga Departamenti i Ujërave të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH)
- Regjionet apo zonat e peshkimit mund tu epen në shfrytëzim personave fizik ose juridik, përkatësisht organizatave ose shoqatave për peshkim ekonomik ose sportiv-rekreativ nga ana e ministrisë.

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

- Regjioni apo zona e peshkimit i jepet në shfrytëzim shfrytëzuesit me tender duke i dhënë të drejtën e menaxhimit nëse i plotëson këto kushte:
 - a) të jetë i regjistruar për kryerjen e aktiviteteve në peshkatari,
 - b) të jetë i pajisur me pajisje dhe staf profesional për zhvillimin e aktivitetit,
 - c) të ketë të organizuara rojet e peshkimit,
 - d) të ofroi programin e menaxhimit për regjionin apo zonën e peshkimit
- Kohëzgjatja e të drejtës së shfrytëzimit të peshkimit në regjionin apo zonën e peshkimit mund të zgjat më së shumti dhjet vjet nëse nuk e përcaktohet ndryshe nga ministria
- Në rastet kur një regjion apo zonë e peshkimit nuk është marrë në shfrytëzim me tender mund të epet në shfrytëzim personave fizik, juridik ose shoqatave të peshkatarëve pa kompensim deri në ritenderim konform nenit 7 të këtij ligji
- Shfrytëzimi nga paragrafi 2 i këtij neni mund të zgjas më së shumti 2 vite

Programet e menaxhimit

- Programi i menaxhimit hartohet nga shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit në përputhshmëri me Kodin e Peshkimit

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Llojet e peshkimit:

- Peshkimi ekonomik: i cili mund të realizohet në regjionet apo zonat e përcaktuara pas marrjes së licencës për peshkim ekonomik nga ministria
- Peshkimi sportiv-rekreativ , i cili mund të kryhet nga peshkatarët që:
 - a) posedojnë leje për peshkim sportiv-rekreativ
 - b) kanë provimin për peshkatar sportiv-rekreativ

Federata e Peshkatarëve Sportiv të Kosovës:

- Federata e Peshkatarëve Sportiv të Kosovës kryen punët për të cilat autorizohet sipas këtij ligji

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

AKUAKULTURA

- Aktivitetin e akuakulturës mund ta zhvillojnë personat fizik apo juridik të regjistruar dhe të licencuar për akuakulturë si dhe shfrytëzuesit e resurseve ujore nëse një gjë të tillë kanë planifikuar me program në regjionin apo zonën për të cilën e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit
- Personat fizik apo juridik mund të zhvillojnë aktivitetin e akuakulturës pasi të kenë marrë licencë nga ministria duke i plotësuar këto kushte:
 - a) nëse personi fizik apo juridik ka përgatitje profesionale apo ka të punësuar profesional,
 - b) kur zbatimi i projektit nuk shkakton efekte negative ndaj mjedisit
 - c) kur zhvillimi i aktivitetit nuk bie ndesh me interesat e sektorëve tjerë që merren me menaxhimin e ujërave,
 - d) kur ndryshimi i destinimit të tokave është në përputhje me ligjin e tokave,
 - e) kur shfrytëzimi i tokave në pronësi shtetërore rregullohet sipas procedurave të autoriteteve që menaxhojnë me tokat,
 - f) kur e drejta e shfrytëzimit të ujërave është rregulluar sipas ligjit për koncesione.

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Kërkesës për licencimin e aktivitetit të akuakulturës duhet bashkangjitur:

- a) certifikatën e biznesit të personit fizik apo juridik,
- b) zona - regjioni ku do të zhvillohet aktiviteti,
- c) sasia dhe cilësia e ushqimit që do të përdoret,
- d) lloji i peshqve apo organizmave tjerë ujor që do të kultivohen,
- e) numri dhe data e vendimit për pagesën e koncesionit për shfrytëzimin e ujit si dhe kontratën për koncesione për shfrytëzimin të ujit,
- f) hapësira e hurdhës ku do të zhvillohet veprimtaria,
- g) kontrolli i cilësisë së ujit,
- h) pëlqimi mjedisor nga Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor (MAPH) për vlerësimin e ndikimit në ambient.

Kohëzgjatja e licencës për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës është 10 vite me mundësi të ripërtrirjes.

Ligji Nr. 02/L-85: PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

TREGTIMI I PESHQVE

- Tregtimin e peshqve mund ta bëjnë prodhuesit, ndërmarrjet dhe personat juridik të regjistruar për tregtim me peshq.
- Shoqatat, organizatat e peshkatarëve sportiv-rekreativ dhe individët nuk mund ta vejnë në qarkullim peshkun e peshkuar.
- Qarkullimi i peshqve mund të bëhet në objektet e prodhuesit-kultivuesit ose në depot për peshq si dhe në objektet tregtare të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

- Gjobat: 100-200, 100-500, 500-1000, 1000-5000 €

Ligji Nr. 02/L-111 PËR BLETARI

Qëllimi:

- Me këtë ligj rregullohet mbarështimi i bletëve, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, mbikëqyrjen e objekteve të prodhimit dhe ruajtjes së prodhimeve të bletëve

Rëndësia e sektorit të bletarisë:

- Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit, burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore, dietike e mjekësore.
- Bletët përmes Pjalimit ose polenizimit ndikojnë në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore.
- Bletët ndikojnë në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullosave duke ripërtërirë natyrën si hallkë të zinxhirit ekologjik.
- Ushtrimi i veprimtarisë së bletarisë realizohet në bletore nga bletaret të cilët janë persona fizik ose juridik dhe të cilët posedojnë shoqëri bletësh dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie sipas dispozitave të këtij ligji.

Ligji Nr. 02/L-111 PËR BLETARI

Regjistri i bletarëve

- Personi fizik apo juridik që merret me bletari është i obliguar të lajmërojë në Drejtorinë Komunale për Bujqësi, deri më 30 prill të çdo viti kalendarik, për numrin dhe vendin e vendosjes së shoqërive të bletëve, për të hyrë në regjistrin e bletarëve.
- Drejtorit Komunal të Bujqësisë obligohen të sjellin regjistrin e bletarëve në MBPZHR në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit të regjistrimit.

Vendosja e bletores

- Bletorja mund të jetë e stacionuar apo lëvizëse.
- Bletari është i obliguar të vendos bletoren në atë mënyrë që të mos pengoi fqinjët, kafshët dhe komunikacionin publik.
- Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të auto rrugëve, hekurudhave dhe aeroporteve.
- Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të fabrikave për prodhimin e sheqerit, lëngjeve, verërave, stallave dhe plehrishteve.
- Ndërmarrjet prodhuese që merren me prodhimin dhe përpunimin e pemëve dhe rrushit si dhe njësit e ngjashme tek të cilat përdorët ambalazhi që është i dëmshëm për bletë, obligohen të mbajnë në vend të mbyllur ambalazhin e përdorur.

Ligji Nr. 02/L-111 PËR BLETARI

- Bletarët, Shoqatat e Bletarëve dhe Lidhja e Bletarëve të Kosovës që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës obligohen të ndërmarrin të gjitha masat preventive për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, sipas dispozitave të Ligjit për veterinarinë dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji.
- Qarkullimi dhe përdorimi i preparateve për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale, duke konsultuar ekspertet e Lidhjes së Bletareve dhe Institutin përkatës.
- Në raste të domosdoshme të spërkatjes së bimëve, bletaret dhe shoqatat e bletarëve duhet të lajmërohen 10 ditë përpara, përmes mediave dhe shpalljeve, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e bletëve.
- Pasi të publikohet lajmërimi mbi vendin dhe kohën e spërkatjes së bimëve me preparate kimike (pesticide) helmuese për bletën, bletari është i obliguar të ndërmerr të gjitha masat mbrojtëse duke i mbyllur dyert e zgjojeve ose duke larguar shoqëritë e bletëve së paku 6 km larg në vijë ajrore nga zona e spërkatjes për një kohë të caktuar
- Nëse bletari nuk i ndërmerr masat adekuate sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk ka të drejt të kërkojë dëmshpërblim nga askush për helmimin e bletëve.

Ligji Nr. 02/L-111 PËR BLETARI

Mjalti që tregtohet për ushqim duhet:

- a) Të jetë i pastër nga çdo shije dhe aromë e huaj, vetëm me aromë të bimës nga e cila është sjell nektari;
 - b) Të mos ketë lagështi mbi 18 %;
 - c) Të mos përmbaj saharozë mbi 5%;
 - d) Përmbajtja e fruktozës dhe glukozës të jetë së paku 65%;
 - e) Të mos ketë filluar procesi i fermentimit;
 - f) Të mos ketë kaluar proceset termike mbi 45 C ;
 - g) Të mos jetë i ngjyrosur me ngjyresës sintetik;
 - h) Të mos ketë konzervans dhe aromatizues
- Mjalti dhe prodhimet e mjaltit duhet të ruhen në vende të thata në temperaturë më të ulët se 25 C dhe lagështi relative të ajrit deri në 80%

Gjobat:

100 deri 500 ; 200 – 2000 Euro

LIGJI Nr. 02/L-122 PËR BUJQËSINË ORGANIKE

- Ky ligj do të aplikohet për prodhimet të cilat mbajnë treguesit të cilat i referohen metodave të prodhimtarisë organike, si vijon:
 - (a) prodhimet bujqësore me origjinë bimore të pa përpunuara, kafshët si dhe prodhimet blegtorale të papërpunuara, të prodhuara në pajtim me parimet e prodhimtarisë dhe rregullat specifike të inspektimit të tyre, të prezantuar në Aneksin I dhe III të këtij ligji;
- Sipas këtij ligji prodhime organike konsiderohen bartësit e treguesve të cilët ju referohen metodave të prodhimtarisë organike, kur në etiketimin, materialin reklamues apo dokumentet përcjellëse, prodhimi i tillë apo përbërësit e tij si dhe materiali ushqyes janë përshkruar sipas treguesit “Bujqësi Organike”, duke siguruar blerësin se ai prodhim apo përbërësit e tij janë përfituar në pajtim me rregullat e prodhimit organik të vendosura sipas nenit 4 të këtij ligji

LIGJI Nr. 02/L-122 PËR BUJQËSINË ORGANIKE

Kushtet për prodhimtarinë organike

Prodhimtaria organike realizohet në kushte specifike, të caktuara si vijon:

- a) izolimi hapësinor i ngastrave tokësore, fermave blegtorale dhe kapaciteteve përpunuese nga mundësia e ndotjes;
- b) toka jo e ndotur, ku niveli i materieve ndotëse është nën nivelin maksimal të lejuar;
- c) kualiteti i pranueshëm i ujit për ujtitje dhe me ndotje minimale të ajrit në regjionin prodhues.

Sistemi i Inspektimit

Ministria do të themelojë:

- (a) një sistem të inspektimit që operon nga një apo më shumë autoritete inspektuese të autorizuara dhe/apo nga subjekte tjera të aprovuara tek të cilët operatorët të cilët prodhojnë apo përgatisin prodhimet e specifikuar në nenin 1 të këtij ligji janë subjekt i inspektimit;

Gjobat:

500 – 5000 Euro

Ligji Nr. 03/L-029 PËR INSPEKSIONIN BUJQËSOR

Qëllimi

- Me këtë ligj përcaktohet puna, kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit

Fushëveprimi

Inspektori kryen punët inspektuese në fushat e bujqësisë:

- tokat bujqësore;
- pylltarisë dhe gjuetisë;
- mbrojtjes së bimëve;
- blegtorisë dhe peshkatarisë;
- veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit.

Kompetencat e Inspektionit

- Mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë inspektorët e nivelit qendror në tërë territorin e Republikës së Kosovës
- Inspektorët komunal kryen inspektimin brenda territorit të komunës sipas autorizimeve ligjore

Punët e Inspektorit

- Inspektori në punën e tij është i pavarur brenda autorizimeve të përcaktuara me ligj dhe akteve të nxjerra në bazë të ligjit.
- Inspektori gjatë punës së tij harton procesverbale, bien vendime, ndërmer masa dhe veprime në kuadër të të drejtave, detyrimeve dhe autorizimeve të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

Të drejta, detyrat dhe autorizimet e Inspektorit

Varësisht nga fusha e inspektimit, inspektori:

- bën kontrollin e hapësirave afariste, objektet, pajisjet, veglat, mjetet, prodhimin, përpunimin, qarkullimin, transportin, eksportin, importin, riekспортin dhe kalimin transit të mallrave;
- kërkon vërtetimin e identitetit të personave si dhe faktet tjera;
- bënë shikimin e akteve, evidencës dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm;
- merr mostrat e mallit dhe mjeteve tjera për analiza, ekspertizë dhe superanalizë;
- merr në pyetje dhe merr deklaratë nga personi përgjegjës dhe personat tjerë
- zbaton procedurën lidhur me kërkesat e qytetarëve dhe subjekteve tjerë dhe për veprimet e ndërmarra e njofton paraqitësin e kërkesës;
- propozon masat preventive me qëllim të parandalimit të shkeljeve të dispozitave ligjore;

Ligji Nr. 03/L-042 I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Qëllimi

- Qëllimi i këtij Ligji është rregullimi i vendosjes në treg dhe kontrollimi i substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimi, qarkullimi, përdorimi, mbetjet në bimë dhe produkte bimore, mbajtjen e regjistrit dhe regjistrin e personave fizik dhe juridik të përfshira për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, kërkesat teknike për pajisjet që përdorën për aplikim dhe elementëve të tyre, përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe monitorimin e tij.
- Ligji rregullon klasifikimin, ambalazhimin, dhe etiketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në pajtueshmëri me Direktivat e Komisionit Evropian.
- Ligji rregullon mbetjet e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, mbeturinat e paketimit të tyre dhe mënyra e emetimit në mjedis .

Ligji Nr. 03/L-042 I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

VENDOSJA NË TREG DHE PERDORIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE (PMB)

- Nuk mund të vendosen në treg apo të përdoren në territorin e Kosovës, PMB që nuk janë të autorizuara ose nuk është lëshuar certifikata e regjistrimit në pajtim me këtë ligj
- Prodhimi, ruajtja, dhe vendosja në treg e një PMB të pa autorizuar nuk do të ndalohet, nëse është vlerësuar që mund të përdoret në ndonjë vend tjetër anëtar i BE-së, i cili vend ka bërë vlerësimin në lidhje me autorizimin e tije
- Një PMB mund të vendoset në treg nëse është i autorizuar nga autoriteti kompetent i Ministrisë, dhe nëse është klasifikuar, ambalazhuar, etiketuar, dhe është shoqëruar me një etiketë dhe me udhëzimin e përdorimit në formë të shkruar në gjuhën zyrtare, në pajtim me këtë ligj.
- PMB nuk mund të vendosen në treg nëse afati i përdorimit të tij ka skaduar

Ligji Nr. 03/L-042 I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Mbetjet e PMB në bimë dhe produkte bimore

- Të gjithë përdoruesit e PMB nuk duhet tejkaluar nivelin maksimal të mbetjeve të caktuara të substancave në bimë ose produkte me origjinë bimore.
- Nëse nivelet e caktuara të mbetjeve në bimë dhe produkte me origjinë bimore, janë tejkaluar me përdorimin e PMB, atëherë këto bime apo produkte me origjinë bimore do të asgjësohen.

Importi i produkteve për mbrojtjen e bimëve

- PMB, lejohen të importohen vetëm nga personat fizik dhe juridik, siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij ligji. Të dhënat për importin e PMB raportohen në zyrat e organit kompetent, sipas nenit 6 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji.
- Importi dhe vendosja e PMB do të mbikëqyret nga inspektorët fitosanitar.
- Ministria me akt nënligjor rregullon pikat e vendkalimit kufitar për importin apo kalimin transit të PMB.

Gjobat:

1000 – 5000

10000 - 30000

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

- **PARIMET E ANALIZËS SË RREZIKUT**
- **PARIMI I KUJDESIT**
- **PARIMI I TRANSPARENCËS**
- **MBROJTJA E INTERESIT TË KONSUMATORËVE**
- **USHQIMI I SIGURTË**

- **Regjistrimi dhe lejimi i objekteve qe afarojne me ushqim**
- **Importi – Eksporti i Ushqimit**

- **OBLIGIMET E SUBJEKTEVE QË AFAROJNË ME USHQIM**
- **Kërkesat që kanë të bëjnë me sistemin e vetëkontrollit**
- Subjekti që afaron me ushqim, përveç nivelit të prodhimtarisë primare, është i obliguar të vendos dhe të mbajë kontrollime të rregullta të kushteve higjienike të prodhimit në secilin objekt nën kontrollin e tij, zbatimin e procedurës preventive të vetëkontrollit të zhvilluar në pajtim me parimet vijuese të sistemit të analizës së hazardit dhe pikave kritike të kontrollit – HACCP

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

USHQIMI I RI DHE ORGANIZMAT TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT OMGJ

Në ushqim të ri bëjnë pjesë këto kategori të ushqimit:

- ushqimi dhe përbërësit e ushqimit të cilët përmbajnë organizma gjenetikisht të modifikuar ose përbëhet nga ata;
- ushqimi ose përbërësit e ushqimit, përveç aditivëve -aromave dhe enzimeve, të cilët janë prodhuar nga OMGJ, por nuk përmbajnë OMGJ;
- ushqimi ose përbërësit e ushqimit me strukturë të re primare ose me strukturë të re molekulare të modifikuar qëllimisht;
- ushqimi ose përbërësit e ushqimit të cilët përbëhen nga mikroorganizmat, kërpurdhat - algët ose janë të izoluara nga ato;
- ushqimi ose përbërësit e ushqimit të cilët përbëhen nga bimët, shtazët, materietnminerale dhe sintetike ose janë të tajitur nga ato, përveç ushqimit dhe përbërësve të

Kategoritë e ushqimit të ri sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk duhet:

- të jenë të rrezikshme për shëndetin e konsumatorit të fundit;
- të shkaktojnë huti te konsumatori;

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

DEKLARIMI I USHQIMIT

- Ushqimi i cili është plasuar në tregun e Kosovës duhet ta ketë deklaratën.
- Deklarata nënkupton të gjitha shenjat e shkruara, emërtimin tregtar, shenjën mbrojtëse, emërtimin e markës, paraqitjen e fotografive ose simbolin i cili i referohet ushqimit dhe vendoset në ambalazh, etiketën ngjitëse ose të varur dhe informatat të cilat e përcjellin ose i referohen atij ushqimi.
- Deklarata duhet të jetë e shkruar në mënyrë të dukshme, si dhe duhet të jetë e lexueshme dhe e kuptueshme.
- Deklarata duhet të përmbajë këto shënime: emërtimin me të cilin ushqimi shitet; listën mbi përbërësit dhe kategorinë e përbërësve të caktuar; sasinë neto për ushqimin e paketuar; afatin e përdorimit; kushtet e ruajtjes, kur ato mund të ndikojnë në skadencën e ushqimit; emrin dhe adresën e prodhuesit ose emrin dhe adresën e atij që e paketon ose e plasoi në treg,
- Për produktet e importuara, krahas emrit dhe adresës së prodhuesit duhet të jetë i shënuar edhe emri, adresa e selisë së importuesit dhe shteti i origjinës,
- Të dhënat e vendit të origjinës së produktit, nëse mungesa e këtyre informatave do të shkaktoje orientim të gabuar te konsumatori mbi origjinën e vërtetë të produktit,

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

KONTROLLI ZYRTAR I USHQIMIT TË SIGURTË DHE HIGJIENA E USHQIMIT

Kontrolli zyrtar i ushqimit të sigurt dhe higjienës së ushqimit përfshinë një a më tepër prej këtyre veprimeve:

- mbikëqyrjen inspektuese;
- mostrimin dhe analizën;
- mbikëqyrjen e deklaratës dhe dokumentacionit si dhe evidencat zyrtare;
- mbikëqyrjen e evidencave nga neni 17 i këtij ligji;
- mbikëqyrjen e zbatimit dhe të efikasitetit të sistemit të vetëkontrollit të objekteve në bazë të verifikimit të evidencave dhe dokumentacionit të cekur në nenin 18 të këtij ligji.

Kontrollin zyrtar të ushqimit e bëjnë inspektorët e Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinarisë e që janë:

- inspektori veterinar;
- inspektori sanitar; dhe
- inspektori fitosanitar - secili në pjesën e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore.

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

LABORATORËT E AUTORIZUAR PËR TESTIM DHE LABORATORËT REFERENT

Agjencia është përgjegjëse për përcaktimin e laboratorëve që kanë të bëjnë me çështjet e ushqimit të sigurt të njerëzve, shëndetit të kafshëve, shëndetit të bimëve dhe mbetjeve.

Laboratorët e autorizuar për testim

- Analizat laboratorike të mostrave të marrura për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimit, duhet të bëhen nga laboratorit i autorizuar nga Agjencia.
- Mostrat i merr inspektori kompetent.
- Shpenzimet rreth kryerjes së analizave për ushqimin e prodhuar në Kosovë i bartë organi kompetent, ndërsa kur ushqimi nuk i përmbush kërkesat e parapara në bazë të këtij ligji dhe të deklaratës, shpenzimet i bartë subjekti që afaron me ushqim të cilin e prodhon ose e plason në treg.
- Shpenzimet rreth kryerjes së analizave për ushqimin e importuar dhe eksportuar në Kosovë ose që tentohet të importohet në Kosovë, i bartë subjekti që afaron me ushqimin.

Ligji Nr. 03/L-016 PËR USHQIMIN

- **MENAXHIMI ME KRIZA DHE RASTE EMERGJENTE**
- **USHQIMI PËR KAFSHË**
- **AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË**

Në këtë Agjenci bashkohen :

- Agjencia e Veterinarisë dhe e Ushqimit të Kosovës,
- Departamenti i Inspektoratit Sanitar të Kosovës,
- Inspektorati Fitosanitar
- Inspektorati Fitosanitarë Kufitar
- Inspektoratet komunale të këtyre shërbimeve.

Organet drejtuese mbikëqyrëse dhe këshillëdhënëse të Agjencisë

- Agjencia përbëhet nga organi drejtues mbikëqyrës dhe këshillëdhënës.
- Organi drejtues është Kryeshefi i Agjencisë.
- Organ mbikëqyrës të Agjencisë është Bordi Drejtues.
- Organ këshillëdhënës i Agjencisë është Këshilli Shkencor

Gjobat: 500 – 3000; 2000 – 10000; 3000 – 20000; 5000 - 50000

Ligjet bujqesore te aprovuara deri tani:

Viti 2009:

16. Ligji Nr. 03/L-098: PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Viti 2012:

17. Ligji nr. 04/L-074: PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

18. Ligji Nr. 04/L-040: PËR RREGULLIMIN E TOKËS

19. Ligji Nr. 04/L-085: PËR BUJQËSI ORGANIKE (Amandamentim, shfuqizohet ai i vitit 2007)

20. Ligji Nr. 04/L-090: PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

21. Ligji Nr. 04/L-121: PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Ligji Nr. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Qëllimi: është përcaktimi i politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural

Fusha e zbatimit:

- Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të Planit për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
- Me këtë ligj përcaktohen dispozitat për ofrimin e shërbimeve publike bujqësore, kërkimit dhe trajnimit profesional, bazën e të dhënave dhe informacionin në fushën e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural

Ligji Nr. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Objektivat e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural

Me masat për zbatimin e politikës bujqësore dhe të zhvillimit të zonave rurale, synohet të arrihen objektivat e përgjithshme:

- konkurrenca në prodhimtarinë bujqësore dhe atë rurale;
- rritja e të ardhurave për popullsinë rurale;
- stabiliteti ekonomik, duke garantuar që prodhimi bujqësor të jetë i qëndrueshëm;
- cilësia e prodhimeve të ushqimit është e mire dhe i plotëson standardet e përcaktuara;
- mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit;
- ndërlidhja e cila synon zvogëlimin e dallimeve ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, duke zhvilluar aktivitete alternative dhe plotësuese që gjenerojnë punësim me qëllim të nxitjes për të jetuar në zonat rurale, duke fuqizuar biznesin e vogël dhe atë të mesëm;
- sigurimi i ushqimit

PROGRAMI, ZBATIMI DHE FINANCIMI I POLITIKËS BUJQËSORE DHE TË ZHVILLIMIT RURAL

Plani Kombëtar i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Plani Kombëtar i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmban Strategjinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural i cili bazohet në analizën aktuale, objektivat afatmesme të politikës bujqësore dhe zhvillimit rural, masat, programet dhe veprimtaritë, në realizimin e këtyre objektivave, në vlerësimet efektive të më pasme si dhe në fondet publike të nevojshme të përdorura për zbatimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.
2. Plani kombëtar i Bujqësisë dhe zhvillimit rural hartohet nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse, dhe me propozim të Qeverisë miratohet në Kuvendin e Kosovës.
3. Plani miratohet për një periudhë prej shtatë (7) vitesh.

Plani i veprimit për zbatimin e politikës së bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Qeveria në përputhje me Planin Kombëtar të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miraton planin e veprimit një apo shumë vjeçar për zbatimin e politikës së bujqësisë dhe zhvillimit rural.
2. Plani i veprimit përfshinë pjesën ose tërë paketën e masave të politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural :
 - 2.1. kushtet, kriteret dhe procedurat e prezantimit dhe të zbatimit të masave të politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
 - 2.2. mjetet dhe mënyrat e zbatimit si dhe kontrollit të zbatimit të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural;
 - 2.3. procedurat e mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Financimi

1. Financimi për politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga:
 - 1.1. buxheti i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. donacionet; dhe
 - 1.3. burimet tjera në përputhje me ligjet në fuqi.

Përfituesit nga masat mbështetëse

- Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, të cilat ndërmerren në kuadrin e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë fermerët, grupet e fermerëve, personat fizik apo juridik të cilët zhvillojnë aktivitete në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Aplikimet

1. Aplikimet për të përfituar fonde nga masat mbështetëse për politikën bujqësore dhe të zhvillimit rural mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh, personat fizik apo juridik siç parashikohet me këtë ligj.
2. Përfituesit duhet t'i përdorin fondet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë dhënë.

Pagesa e mjeteve

- Pagesa e mjeteve për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga Agjencia e Pagesave (AP) për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Dokumentet që duhen mbajtur

1. Përfituesit të cilët kanë marrë fonde nga masat mbështetëse duhet të mbajnë për një periudhë katër (4) vjeçare në vijim, duke filluar nga data e lëvrimit të fondit, dokumentacionin i cili është përdorur për përfitimin e fondeve.
2. Dokumentacioni që duhet mbajtur nga përfituesit përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

Agjencia e Pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Themelohet në kuadër të Ministrisë dhe ka kompetencat si në vijim:
 - 1.1. zbatimin e masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural;
 - 1.2. hartimin e raporteve dhe të analizave në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
 - 1.3. ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
 - 1.4. ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
 - 1.5. krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të nevojshme;
 - 1.6. zbatimin e masave të kontrollit dhe auditimit të brendshëm;
 - 1.7. inspektimin e fermerëve dhe subjekteve që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
2. Agjencia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural zbaton programe të mbështetjes ndërkombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
3. Organizimi, funksionimi dhe puna e Agjencisë së Pagesave, përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

MASAT E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT RURAL

Masat e politikës së zhvillimit rural mbështesin:

- përmirësimin e konkurrencës së bujqësisë dhe të industrisë agro-ushqimore në zonat rurale;
- menaxhimin e tokës dhe mbrojtjen e mjedisit;
- përmirësimin e cilësisë së jetës dhe veprimtarive ekonomike në këto zona;
- përmirësimin e qeverisjes dhe mobilizimin e potencialeve lokale zhvillimore të zonave rurale, si dhe krijimin e iniciativave lokale.

Masat propozohen me Planin Kombëtar të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe rregullohen nëpërmjet Planit të Veprimit.

Mënyra e zbatimit të këtyre masave dhe kriteret e mbështetjes përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

Mbështetja për përmirësimin e konkurrencës në bujqësi dhe në industrinë agro-ushqimore

1. Mbështetja për përmirësimin e konkurrencës në bujqësi dhe në industrinë agro-ushqimore bazohet në masa investuese dhe mbështetëse përmes projekteve të cilat përmirësojnë gjendjen lidhur me:

- 1.1. zhvillimin e trajnimeve profesionale për ngritjen e kapaciteteve njerëzore;
- 1.2. ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural;
- 1.3. menaxhimin e resurseve ujore për bujqësinë;
- 1.4. përmirësimin e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore.

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe inkurajimin e shumëllojshmërisë të veprimtarive ekonomike në zonat rurale

1. Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe inkurajimin e shumëllojshmërisë së veprimtaritë ekonomike në zonat rurale ndihmon në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve socialo-ekonomike në zonat më të largëta rurale që ndeshen me fenomenin e migrimit social të popullatës.
2. Kjo mbështetje bazohet në masa të ndryshme investuese dhe të përkrahjes nëpërmjet projekteve të cilat fuqizojnë investimet në ekonominë e gjerë rurale dhe përmirësojnë gjendjen lidhur me:
 - 2.1. shumëllojshmërinë e fermave dhe veprimtaritë alternative në zonat rurale;
 - 2.2. ripërtirja dhe zhvillimi i fshatrave, ruajtja dhe përmirësimi i trashëgimisë rurale.

Mbështetja për krijimin e iniciativave lokale

1. Përkrahja stimulon krijimin e iniciativave që përfshijnë fermerët, punonjësit e pyjeve dhe akterë të tjerë rural të cilët mund të ruajnë dhe të rrisin mëtej trashëgiminë lokale natyrore dhe kulturore, të ngritin ndërgjegjësimin për ruajtje të mjedisit dhe të promovojnë produktet tipike, turizmin dhe burimet e ripërtirja të energjisë.
2. Veprimet kryesore të mbështetjes në këto zona përfshijnë:
 - 2.1. krijimin e kapaciteteve lokale të partneritetit, grupeve lokale të veprimit, dhe promovimin e aftësive të investimeve, të cilat mund të ndihmojnë në mobilizimin e potencialit lokal;
 - 2.2. promovimin e partneritetit publik-privat;
 - 2.3. promovimin e bashkëpunimit, inkurajimit të aftësisë së ndërmarrjeve dhe promovimin e përfshirjes së shërbimeve lokale që ofrohen;
 - 2.4. përkrahjen në zbatimin e strategjive zhvillimore të komunitetit lokal.

STRUKTURA ISNSTITUCIONALE PËR POLITIKËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Komiteti ndërministror për bujqësi dhe zhvillim rural

- Me këtë ligj, themelohet Komiteti ndërministror për bujqësi dhe zhvillim rural si organ këshillëdhënës i Qeverisë.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit ndërministror përcaktohen më akte nënligjore nga Qeveria.

Komiteti ndërministror për bujqësinë dhe zhvillim, rural përveç detyrave të tjera, jep mendime dhe propozime për vendimet me të rëndësishme të Qeverisë në fushën e bujqësisë dhe të zhvillim rural, lidhur me:

- propozimet për Planin Kombëtar të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- mbikëqyrjen dhe zbatimin e Planin Kombëtar të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- propozimet për aktet nënligjore në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- vendimet e tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

BAZA E TË DHËNAVE DHE SISTEMI I INFORMIMIT

Baza e të dhënave: Ministria krijon bazën e të dhënave e cila përmban:

- regjistrin e fermave;
- regjistrin e prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve bujqësore dhe ushqimore;
- regjistrin e shfrytëzimit të tokës bujqësore;
- regjistrin e blegtorisë;
- regjistrin e tregtarëve të produkteve dhe pasurive bujqësore;
- regjistrin e zonave më pak të zhvilluara.

Shfrytëzimi i informatave nga bazat tjera të të dhënave

- Me themelimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, Ministria mund të përdor edhe baza të dhënash të tjera, të cilat mbahen nga: institucionet, agjensitë publike dhe autoritete të tjera të autorizuara.
- Ministria merr të dhënat nga institucionet e tjera si: hartat, fotot dhe orto - fotot digjitale sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Financimi i bazës së të dhënave

- Baza e të dhënave që krijohet dhe menaxhohet nga Ministria siç është përcaktuar në këtë ligj, financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Vënia në dispozicion e të dhënave

- Të dhënat e krijuara nga baza e të dhënave në përputhje me këtë ligj janë publike, përveç të dhënave të tjera, të cilat konsiderohen si të dhëna personale dhe përbëjnë sekret të biznesit.
- Të dhënat, të cilat konsiderohen si të dhëna personale duhet të vihen në dispozicion të palëve të treta në përputhje me Ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Sistemi i informacionit për çmimin e tregut

- Sistemi i informacionit për çmimin e tregut përbëhet nga grumbullimi, zbatimi dhe publikimi i të dhënave për çmimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.
- Ministria përcakton tregun përfaqësuese të produkteve bujqësore dhe ushqimore, personave fizik apo juridik që do të japin të dhëna, duke përcaktuar tipin, vëllimin dhe kohën e grumbullimit të të dhënave.
- Sistemi i informacionit për çmimet e tregut krijohet dhe përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

Kontabiliteti në fermë

- Për përfituesit nga masat e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural, është i detyrueshëm mbajtja e kontabilitetit. Fermat jo përfituese mund të mbajnë kontabilitet në baza vullnetare.
- Kriteret për përcaktimin e fermave që do të jenë pjesë e sistemit të mbajtjes së kontabilitetit përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.
- Ministria është përgjegjëse për zbatimin teknik dhe organizativ të kontabilitetit në fermë.
- Mbikëqyrja dhe zbatimi i kontabilitetit në fermë, bëhet nga komisioni i formuar me vendim të Ministrisë.
- Të dhënat e përfituara nga mbajtja e kontabilitetit në ferma mund të përdoren në përputhje me
- Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

FORMAT E ORGANIZIMIT TË PRODHUESVE, PËRPUNUESVE DHE TREGTUESVE TË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE AGRO- USHQIMORE

- Prodhuesit, përpunuesit dhe tregtuesit e produkteve ushqimore dhe agro-ushqimore mund të organizohen në forma të ndryshme për të përfituar mbështetje në bujqësi.
- Kriteret që duhet të përmbushin organizatat dhe shoqatat e prodhuesve dhe përpunuese të produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore, për të përfituar mbështetje përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria

SHËRBIMET PUBLIKE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Qëllimi i shërbimeve publike në bujqësi dhe zhvillim rural është mbështetja e zbatimit të Planit të Zhvillimit Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për të ofruar shërbime afatgjata e të përhershme në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, nëse iniciativa private nuk mund të përmbushë nevojat publike.

Shërbimet publike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë:

- shërbimet këshillimore në bujqësi dhe zhvillimin rural;
- hulumtimet bujqësore dhe analizat laboratorike;
- shërbimet e ruajtjes së racës dhe varieteve në bujqësi e blegtori;
- analizat e politikave bujqësore;
- shërbimet e infrastrukturës së tregut dhe marketingut.

Detyrimet e një shërbimi publik

Shërbimet publike në bujqësi dhe zhvillim rural përfshijnë:

- realizimin e vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të aktivitetit të shërbimit të përcaktuar;
- realizimi i këtij shërbimi për çdo fermer, grup fermerësh, person fizik apo juridik të angazhuar në aktivitetin bujqësor në përputhje me këtë ligj;
- ofrimi i shërbimit në përputhje me programin e miratuar;
- cmimet e shërbimeve të ofruara nga shërbimi publik në fushën e bujqësisë përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Programi i shërbimit publik

- Programi i shërbimit publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural hartohet dhe miratohet nga Ministria në përputhje me Planin e Zhvillimit Kombëtar dhe duhet të specifikojë:
- llojin dhe vëllimin e shërbimit publik, i cili ofrohet nga ky shërbim;
- mënyrën, procedurën dhe dinamikën e realizimit të shërbimit publik.

Mbikëqyrja e shërbimit publik

- Mbikëqyrja teknike dhe profesionale për ofrimin e shërbimit publik bëhet nga Ministria, e cila mund të autorizojë subjektin tjetër për realizimin e mbikëqyrjes teknike.
- Mbikëqyrja teknike dhe profesionale, në rastin e autorizimit publik, bëhet nga personat të cilët janë të autorizuar për ushtrimin e kontrollit në fushën specifike të shërbimit publik.
- Kriteret që zbatohen dhe që kërkohen për kualifikimin profesional të mbikëqyrjes përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

MBËSHTETJA PER HULUMTIMIN, ARSIMIMIN DHE TRAJNIMIN

Hulumtimet në bujqësi

- Në përputhje me Planin për Zhvillim Kombëtar, Ministria në bashkëpunim me ministritë përkatëse si dhe në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat shkencore të tyre, bashkë financon hulumtimin e projekteve zhvillimore në bujqësi dhe zhvillim rural dhe infrastrukturë përkatëse.

Arsimimi dhe trajnimi për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural

- Ministria propozon dhe ndërmerr iniciativa të ndryshme të arsimit dhe trajnimit për nevojat e bujqësisë, agro-industrisë dhe zonave rurale në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet tjera arsimore të specializuara në lëmin e bujqësisë.
- Ministria mund të bashkë financojë iniciativa për sigurimin e pajisjeve të zbatimit praktik të arsimit dhe të trajnimit për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.
- Përfitues të trajnimeve janë fermerë, punonjës dhe specialistë të bujqësisë dhe të agroindustrisë.

Studimet analitike dhe zhvillimore

- Ministria kryen studime analitike dhe zhvillimore në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat shkencore të tyre, kryesisht në:
 - realizimin e analizave ekonomike dhe të tjera të ndikimit në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agro-industrisë;
 - realizimin e analizave dhe të aktiviteteve planifikuese në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agro-industrisë;
 - përmbushjen e përgjegjësive të rëndësishme për trajnimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve zhvillimore në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agro-industrisë.

INSPEKTIMI

Mbikëqyrja

- Zbatimin dhe inspektimin e këtij ligji e bën Ministria.
- Sipas dispozitave të këtij ligji inspektimin do ta bëjnë inspektori bujqësor, inspektori i veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara me ligj.

Rastet e kundërvajtjeve administrative dhe sanksionet administrative

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

- mos mbajtja e dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë katër (4) vjeçare.
- për kundërvajtjen administrative të përcaktuar sipas nën-paragrafit 1 të këtij neni, inspektori vendos gjobë në masën njëqind (100) deri treqind (300) euro.

ANKESA

Procedura e ankesës

- Kundër vendimit të inspektorit mund të paraqitet ankesë me shkrim të udhëheqësit të inspektionit përkatës në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i cili brenda 30 ditësh duhet të jap përgjigjen me shkrim parashtruesit të ankesës.
- Kundër vendimit të Udhëheqësit të inspektionit përkatës, pala mund të paraqesë ankesë në
- Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) dite.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Kundërvajtjet

- Për kundërvajtje me gjobë prej një mijë (1000) deri pesë mijë (5000) euro dënohet personi që:
- nuk i përdor fondet për qëllimet e destinuara si përfitues në pajtim me nenin 8 të këtij ligji.
- nuk ruan dhe nuk i paraqet personit të autorizuar dokumentacionin në periudhën katër (4) vjeçare sipas nenit 11 të këtij ligji.
- pengon personin e autorizuar në kryerjen e inspektimit, sipas nenit 35 të këtij ligji.
- Të gjitha pagesat që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji si dhe të hyrat tjera nga taksat, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji duhet të nxirren në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- Planet dhe programet e dala në bazë të këtij ligji duhet të miratohen brenda dymbëdhjetë (12) muajsh.

Ligji nr. 04/L-074 PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Qëllimi

- Ky ligj rregullon organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, marrëdhëniet ndërmjet palëve me interes me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Republikën e Kosovës
- Ngritjen e nivelit të përgjithshëm të njohurive të fermerëve, trajnimin e tyre për të menaxhuar fermën, rritjen e të ardhurave në fermë, mbështetje në zgjidhjen e problemeve që lidhen me prodhimin, çështjet ekonomike dhe organizative për zhvillimin e fermave, ruajtjen e burimeve natyrore, mjedisit, përcjelljen e të arriturave dhe trendët në BE, duke u bazuar në kërkesat e tregut.

Ligji nr. 04/L-074 PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Këshilltari për bujqësi është i obliguar të:

- këshilloj fermerët sipas prioriteteve që ata i kanë përcaktuar në fermë dhe shoqatë;
- prezantoj praktikat me te mira të menaxhimit të biznesit të fermave, të praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe të ndërmarrjeve jo-bujqësore rurale;
- stimulon fermerët për përdorimin e metodave për prodhimtarin bujqësore të cilat mundësojnë ruajtjen e burimeve natyrore dhe pjellshmërinë e tokës përmes zbatimit të bujqësisë ekologjike dhe rritjen e nivelit të cilësisë dhe sasisë të kulturave bujqësore dhe prodhimeve rurale;
- bëjë nxitjen e fermerëve në përshtatjen e prodhimtarisë me kushtet dhe rrethanat natyrore të regjioneve dhe tregjeve;
- bëjë nxitjen dhe përkrahjen e fermerëve në organizimin e tyre në kooperativa dhe shoqata si dhe përkrahjen e tyre me shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural;
- mbështet Ministrinë në kuadër të implementimit të programit për zhvillim rural dhe masat për pagesa direkte përmes dhënies së këshillave rreth PZHR-së dhe pagesat direkte, aktivitetet informuese, mbështetje fermerëve...

Ligji nr. 04/L-074 PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Organizimi i shërbimeve këshilluese publike dhe private

- Për kryerjen e aktiviteteve të shërbimeve këshilluese është përgjegjës shërbimi këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural i cili organizon dhe ushtron shërbimin këshillues sipas ligjit, kërkesave të fermerëve dhe komunitetit
- Shërbimi këshillues është publik dhe privat

Organizmi i shërbimeve këshilluese publike

Shërbimet këshilluese publike janë të organizuara dhe shtrihen në:

- niveli qendror;
- niveli komunal

Shërbimi këshillues privat

- Shërbimi këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural mund të ofrohet edhe nga këshilltaret privat si persona fizik dhe juridik;
- Shërbimi këshillues privat financohet nga të ardhurat e gjeneruar nga shërbimet e ofruara dhe nga donacionet tjera.

Ligji Nr. 04/L-040: PËR RREGULLIMIN E TOKËS

Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është krijimi i bazës ligjore për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokave bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore në funksion të shfrytëzimit më racional dhe më ekonomik

Fusha e Zbatimit

- Me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve që janë kompetente për rregullimin e tokës, procedurat për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi.

Qëllimi i Rregullimit

- grupimi i tokës për shfrytëzim më racional dhe ekonomik,
- krijimi i parcelave me formë të rregullt gjeometrike;
- përmirësimin e tokës përmes zbatimit të masave agro-teknike, agro-melioruese dhe hidro-melioruese;
- përmirësimi i infrastrukturës duke përfshirë qasjen në infrastrukturën publike;
- ripyllëzimi i tokës të cilësisë më të dobët ose tokës së ndotur;
- matjet e reja të tokës;
- krijimi i kadastrës së re.

Ligji Nr. 04/L-040: PËR RREGULLIMIN E TOKËS

Shpenzimet për zbatimin e rregullimit të tokës

- Shpenzimet për zbatimin e rregullimit të tokës i bartë Ministria.
- Për shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni Ministria do t'i ngarkoj palët e përfshira sipas buxhetit, të caktuar në projektin për rregullimin e tokës
- Shpenzimet nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni nënkuptojnë investimet dhe shpenzimet e punimeve që kryhen për Projektin e Rregullimit të Tokës.
- Investimet dhe shpenzimet e punimeve nënkuptojnë shpenzimet për ndërtimin e rrjetit të ri të rrugëve në masën e rregullimit të tokës, kanaleve dhe urave, rregullimit të përrenjve, largimit të objekteve, mezhdave, lëvrimit të rrjetit të vjetër rrugor dhe të sipërfaqeve tjera të pa punuara.

Ligji Nr. 04/L-121

PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Qëllimi

Me këtë ligj rregullohen dhe mbrohen të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në tregun e lirë si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit;

- Ky ligj është i zbatueshëm për çdo konsumator i cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës si dhe personave tjerë jorezident
- Ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhueseve, shitësve, furnizueseve, ofrueseve të shërbimeve nga ana tjetër për ta mbrojtur konsumatorin nga praktikat e padrejta në tregun e mallrave dhe të shërbimeve në Republikën Kosovës.

Të drejtat e konsumatorit

Ky ligj garanton këto të drejta themelore të konsumatorëve:

- Të drejtën për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit;
- Të drejtën për të mbrojtur nga rreziku jetën, shëndetin dhe pronën;
- Të drejtën për mbrojtje ligjore të konsumatorit;
- Të drejtën për tu ankuar;
- Të drejtën për kompensim në raste të caktuara edhe për dëmshpërblim;
- Të drejtën për informim dhe edukim të konsumatorit;
- Të drejtën për shfrytëzimin e shërbimeve publike;
- Të drejtën e organizimit në shoqata të konsumatorit për të mbrojtur interesat e tyre;
- Të drejtën për të përfaqësuar interesat e tyre;
- Të drejtën për të marr shërbime në gjuhën e tij në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare sipas ligjit në fuqi.

Detyrimet e shitësit

- Shitësi përmbush detyrimet ndaj konsumatorit në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;
- Shitësi me kërkesë të konsumatorit pas konstatimit të të metave të mallit detyrohet të bëjë zëvendësimin e mallit ose kthimin e të hollave të paguara për mallin ose me pëlqimin e konsumatorit, të ul çmimin për të kompensuar mangësitë ose të metën e mallit;
- Shitësi për shkak të mangësive në shërbimet e kryera, me kërkesën e konsumatorit është i detyruar për t'ia kthyer shumën e paguar për shërbimin, të eliminojë mangësitë në shërbimet e ofruara, apo të zbret çmimin sipas kontratës me konsumatorin;
- Konsumatori sipas paragrafit 2. dhe 3. këtij neni, mund të kërkojë kthimin e shumës së paguar vetëm nëse i kishte dhënë më parë shitësit një afat të arsyeshëm për eliminimin e të metave të mallit ose shërbimit për përmbushjen e kontratës;
- Në rast të kontesti gjyqësor apo jo gjyqësor mangësitë e mallit apo shërbimit të kryer vërtetohen me anë të dëshmisë së ekspertit gjyqësor ose me ndihmën e një vlerësuesi tjetër të certifikuar. Shpenzimet e ekspertizës do ti mbulojë konsumatori ose tregtari, në varësi të rezultatit të ekspertizës;
- Nëse shitësi gjatë periudhës së garancionit nuk mund të riparojë mallin e dëmtuar për të cilin ka dhënë garancionin, atëherë detyrohet që konsumatorit t'i japë mallin e ngjashëm apo t'ia kthejë mbrapa të hollat me dëmshpërblim.

Kërkesat e sigurisë së përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve

- Prodhuesit dhe shitësit duhet të vendosin në treg mallra të sigurta, në përputhje me ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.
- Ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë shërbime të sigurta, duke marrë parasysh:
 - karakteristikat e shërbimit;
 - efektin e shërbimit mbi mallrat dhe shërbimet e tjera;
 - paraqitjen e shërbimeve, paralajmërimet ose informacionin në lidhje me shërbimet; duhet të jenë në gjuhët zyrtare sipas ligjit në fuqi;
 - kategoritë e konsumatorëve të rrezikuar, kur përdorin shërbimin, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit si konsumatorët me ndjesi të veçantë ndaj disa, mallrave dhe shërbimeve ndaj të sëmurit;
 - rreziqet e mundshme që mund të shkaktojë shërbimi nëse nuk përdoret siç duhet.

Kushtet e shitjes së mallrave dhe ofrimit të shërbimeve

- Ekspozimi i mallit i cili në pikën e shitjes paraqitet si eksponat, nuk konsiderohet ofertë dhe tregtari mund të refuzojë shitjen e atij malli. Ofruesi i shërbimeve mund të refuzojë shërbimin që është subjekt i biznesit të tij, varësisht nga rrethanat specifike të rastit;
- Shitësi duhet të ofroj kushtet e shitjes të mallrave apo shërbimeve në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme dhe ti paraqes në momentin e ekspozimit të tyre në hapësirën e shitjes. Kushtet e veçanta për kategori të caktuara të konsumatorëve që ofron tregtari, për mallin e caktuar duhet të jenë të qarta, të dukshme dhe të lexueshme dhe të shfaqen në momentin e shfaqjes së tyre në pikat e shitjes së këtyre mallrave;
- Shitësit i ndalohet publikimi i të dhënave apo çfarëdo informacioni personal për konsumatorin, ndonjë palë të tretë pa pëlqimin dhe autorizimin me shkrim të konsumatorit, përveç me vendim të gjykatës kur informatat i nevojiten organeve kompetente për hetimin e rasteve;
- Ofruesi i shërbimeve për çdo riparim dhe mirëmbajtje të mallrave duhet t'i lëshojë një faturë konsumatorit me përshkrim të shërbimeve dhe të materialeve të përdorura për riparim. Fatura duhet të nënshkruhet nga ofruesi i shërbimeve dhe konsumatori dhe një kopje e faturës duhet të dorëzohet konsumatorit;
- Në rastet e përcaktuara në paragrafin 4. këtij neni, nëse paraqitet nevoja për riparim apo punë shtesë apo instalimin e komponentëve të nevojshme, ofruesi i shërbimeve duhet të marrë pëlqimin me shkrim nga konsumatori, ose me anë të komunikimit në largësi, nëse kostoja e shërbimit rritet

Ankesat e konsumatorëve ndaj shitësve ose ofruesve të shërbimeve

- Konsumatori për çdo ankesë mund të drejtohet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit në MTI;
- Konsumatori mund ta bëjë ankesën përmes qendre së thirrjeve (telefonike) apo në formë elektronike apo edhe në formë të shkruar;
- Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit detyrohet që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i ankesës që ta njoftoj konsumatorin lidhur me ankesën e tij;

Vendosja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve

- Shitësi duhet të vendos qartë, dukshëm dhe lexueshëm çmimin e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe çmimin për njësi të mallrave apo shërbimeve të ofruara;
- Çmimi me pakicë dhe shumicë përfshin çmimin përfundimtar për çdo mall apo shërbim, ose për një sasi të caktuar të mallrave, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar;
- Shitësi duhet të garantoj konsumatorit se çmimi i paguar do të jetë i njëjtë me çmimin e ekspozuar sipas paragrafit 2. të këtij neni;
- Çmimi për njësi matëse do të thotë çmimi përfundimtar për njësi matëse, çmimi për kilogram, litër, metër, metër katror, metër kub të mallit ose disa njësi të tjera matëse duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar konformë paragrafit 2. të këtij neni;
- Për mallrat e papaketuara, refuz çmimi për njësi matëse të mallit të ofruara në treg vendoset pranë mallit.
- Për mallrat e para-paketuara, është e mjaftueshme vendosja e çmimit neto për njësi në qoftë se me rregullat tjera të veçanta në të dhënat për peshën neto, nuk është përcaktuar ndryshe;
- Çmimi i shitjes me pakicë dhe çmimi për njësi të para-paketuara i mallrave do të vendoset në ose pranë mallit, paketimit ose pikës së shitjes si dhe në raftet. Përveç çmimit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk lejohet kurrfarë çmimi tjetër, përveç në rastin e shitjes me aksion, uljes së çmimit apo me rastin e falimentimit të kompanisë;
- Shitësi duhet të vendos çmimin në mënyrë që të mos dëmtojë mallin;
- Dispozitat e paragrafit 8. të këtij neni nuk do të zbatohen për ankande publike dhe shitjen e veprave të artit, veprave antike si dhe shërbimeve të rregulluara me aktet tjera në fuqi.

Çmimet në reklama

- Çmimi me pakicë i mallrave apo shërbimeve dhe çmimi për njësi i mallit që publikohen në reklama, duhet të jetë i njëjtë me çmimin e përcaktuar konform dispozitave të nenit 9 këtij ligji;

Pagesa e detyrimeve financiare

- Detyrimet financiare që konsumatori paguan përmes bankës, postës apo institucioneve tjera financiare do të konsiderohet i paguar në datën kur institucioni i tillë të marrë urdhërpagesën e konsumatorit;

Fatura

- Shitësi për çdo mall të shitur ose shërbim të ofruar për konsumatorin duhet të jap faturë e cila duhet të jetë e saktë, e pashlyeshme, e qarte, e dukshme dhe e lexueshme në letër apo formë elektronike;
- Shitësi i mundëson konsumatorit për të kontrolluar sasinë e faturuar në lidhje me mallin e blerë apo shërbimin e ofruar;
- Shitësi duhet t'u përmbahet kushteve të deklaruara dhe çmimit të shitjes me pakicë;
- Faturimi nuk lejon pagesë plotësuese përveç asaj që është cekur në faturë;
- Çmimet administrative dhe çmimet e shërbimeve publike si energjia, uji dhe shërbimet e telekomunikimit rregullohen me ligje të tjera;
- Për shërbime tjera si transporti i udhëtarëve duhet të jepet fature ose biletë individuale.

Etiketa

- Shitësi i mallrave dhe/apo shërbimeve duhet të sigurojë që mallrat që shet të jenë të pajisura me etiketë, e cila përmban informacione për prodhuesin dhe adresën e tij, emërtimin e mallit, sasinë, përbërjen, cilësinë, datën e prodhimit, afatin dhe mënyrën e përdorimit, mirëmbajtjes si dhe rrezikshmërinë nëse ekziston;
- Informacioni për etiketim për mallrat ushqimore rregullohet me akt nënligjor.
- Shitësi nuk ka të drejtë të heqë ose të ndryshojë etiketën e mallit apo informacionet e tjera lidhur me mallrat e dhëna nga prodhuesi dhe/ose furnizuesi;
- Nëse natyra e mallit nuk e lejon vendosjen e etiketës, shitësi është i detyruar të sigurojë, sipas kërkesës së konsumatorit, informacionin në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, në mënyrë tjetër apo edhe përmes paraqitjes së dokumenteve përkatëse;
- Shitësi me rastin e vendosjes në treg të mallit detyrohet të vendos etiketën, në të gjitha mallrat e paketuara;
- Për mallrat e papaketuara, refuz duhet të siguroj një udhëzues të përgatitur nga prodhuesi për mënyrën e përdorimit më të lehtë dhe më të sigurt, pastaj ti ofroj garancionin, udhëzime teknike, listën për serviset e autorizuara, një liste për paralajmërim nga rreziqet e mundshme gjatë përdorimit dhe një deklaratë të konformitetit të mallrave;
- Etiketa duhet të jetë e shkruar qartë, dukshëm dhe e lexueshme në gjuhët zyrtare sipas ligjit ne fuqi;
- Përkthimi i të dhënave në gjuhët zyrtare sipas ligjit ne fuqi, të vendosura në etiketë nga prodhuesi, për të bërë më të lehtë informimin e konsumatorit lidhur me sigurinë e përdorimit të mallit, në paragrafin 1. të këtij neni duhet të jetë identike me origjinalin;

Paketimi

- Paketimi duhet të jetë i sigurt për shëndetin, forma e paketimit duhet të përshtatet me peshën e mallit dhe nuk duhet të shkaktoj tek konsumatori huti pështa dhe madhësia e mallit të cilat duhet të jenë në përputhje me rregulloret e veçanta për përshkrimin e recetave të udhëzuesit për paketim;
- Në rastin e mbështjelljes së ambalazhit me letër të veçantë dhe dekorime të tjera, çmimi i mallrave të paketuara duhet të paraqitet në mënyrë të qartë, dukshëm dhe lexueshëm;
- Qeset të cilat përdoren për bartjen e mallrave të blera që kanë logon e plotë ose të pjesëshme, markë tregtare, slogan ose emrin e prodhuesit ose tregtari do të konsiderohen materiale promovuese dhe nuk i llogaritet konsumatorit për pagesë;
- Shitësi duhet t'i mundësojë konsumatorit kthimin e ambalazhit të cilën e ka paguar kur e ka blerë mallin si dhe t'ia kthejë shumën që e ka paguar për ambalazhin;

Deklaracioni i mallit :

- Deklaracioni është i detyrueshëm të vendoset në çdo mall dhe duhet të paraqitet me shkrim dhe shenja lidhur me specifikat e mallit që kanë të bëjnë me shenjen tregtare, markën tregtare, emri i markës, shenja ose simboli në lidhje me mallin dhe të vendosen në etiketë, në paketim ose dokumentet dhe informacionet përcjellëse për mallin.
- Deklaracioni i mallit, duhet të përmbajë këto informacione:
 - emrin e prodhuesit të mallit dhe emri me të cilin shitet malli;
 - llojin, modelin, njësinë matëse dhe etiketën e mallit dhe se paku një specifikë të rëndësishme që e veçon atë mall;
 - datën e prodhimit dhe afatin e skadimit;
 - për mallrat vendore, emrin dhe adresën e prodhuesit dhe vendin e origjinës;
 - për mallin e importuara, emrin dhe adresën e importuesit dhe vendin e origjinës së prodhuesit;
- Vendosja e informatave në deklaracion sipas paragrafit 2. të këtij neni rregullohet me akt nënligjor.
- Përrjashtimisht dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni nuk zbatohen për mallrat të cilat janë të rregulluara me dispozitat e ligjeve tjera në fuqi;
- Emrin e prodhuesit të mallit sipas nën-paragrafit 2.1. të paragrafit 2. të këtij neni sipas të cilit malli i cili shitet duhet të vendoset shenja ose përshkrimi i mallit, përdorimi i saktë për të mundësuar njohjen e konsumatorit me mallin e kërkuar i cili dallohet nga mallrat tjera të ngjashme me të cilat ajo mund të zëvendësohet;
- Adresa e plotë nga paragrafi 2. i këtij neni detyrimisht duhet të përmbajë vendin, rrugën dhe numrin e shtëpisë, numrin e telefonit, faksit adresën elektronike nëse ato ekzistojnë;
- Vendi i origjinës referuar në nën-paragrafët 2.4. dhe 2.5. të paragrafit 2. të këtij neni do të konsiderohet vendi ku malli është prodhuar apo vendi në të cilin malli i është nënshtruar një procesi i cili ka ndryshuar ndjeshëm specifikat e atij malli

Njoftimi për përmbajtësit e mallit

- Njoftimi për përmbajtjen e mallit duhet të vendoset në mall ose paketim. Përgjegjësin për të dhënat e vendosura në mall apo paketim e bartë shitësi;
- Të gjitha informacionet me të dhënat për mallin nga paragrafi 2. neni 17 i këtij ligji duhet të jenë të qarta, të dukshme, të lexueshme dhe të shkruara në gjuhën shqipe dhe nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm të gjuhëve të tjera zyrtare si dhe shenja të kuptueshme për konsumatorin. Për të dhënat mbi përmbajtjen e mallit përgjegjës është prodhuesi, kurse për ato të importuara përgjegjës është importuesi;
- Të dhënat për përmbajtjen e mallit duhet të jenë të qarta, të dukshme, të kuptueshme, të lexueshme, të pashlyeshme dhe nuk duhet të mbulohet me ndonjë tekst tjetër;
- Për të dhënat mbi përmbajtjen e mallrave të pa paketuara, refuz, njoftimi duhet të vendoset pranë paketimit në të cilën malli është vendosur ose në pikën e shitjes në qoftë se malli nuk kërkon kushte të veçanta të sigurisë nga prishja;
- Njoftimi i mallit duhet të jetë i theksuar në mënyrë që të mos dëmtojë mallin;